



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 10 dhe 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me Nr. 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) – Gjakovë shpall këtë:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen bletarët e Komunës së Gjakovës, që të aplikojnë për skemën e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetjen e tyre me pajisje për bletari, gjegjësisht me **Shkrirëse Dylli**.

Kriteret e përgjithshme:

- Ndarja proporcionale sipas rajoneve – pesë (5) rajone;
- Fermeret femra, minoritetet dhe të rinjtë kanë përparësi;
- Duhet të ketë minimum 30 koshere bletë;
- Përfituesit duhet të bashkëfinancojnë vlerën e projektit minimum 20%;
- Aplikuesit të mos jenë përfitues nga Komuna në sektorin e bletarisë nga viti i kaluar;
- Përfituesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës dhe të ketë bletoren në territorin e Komunës së Gjakovës;
- Numri identifikues i fermerit (NIF) duhet të jete i vendosur në shabllon, në përmasat 30 x 12cm, në trupin e kosheres, jo në kapak i shënuar me ngjyrë të përhershme.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fotokopja e letërnjoftimit
- Numri identifikues i fermerit (NIF)
- Dëshmia individuale e deklaramit të numrit të koshereve
- Vërtetimi i tatimit në pronë

Fletë aplikacioni tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) të Komunës së Gjakovës.

Afati i aplikimit: **18.07.2022 deri me 08.08.2022**

Gani Hajdari
Drejtori i DBPZHR

